

Taksa

# 100%



**AKTUALITET**

~~€0.70~~ €1.20  
~~€0.80~~

A po e ndihmon apo  
dëmton ekonominë e Kosovës?

Efektet ekonomike të taksës 100% ndaj produkteve të  
Serbisë dhe Bosnjes e Hercegovinës

**Maj 2019**

## **Përmbajta**

<b>1. Hyrje</b> .....	5
<b>2. Rregullimi i tregtisë mes Kosovës dhe Serbisë 1999-2018</b> .....	6
<b>3. A është taksa në kundërshtim me marrëveshjen e CEFTAs?</b> .....	8
<b>4. Ndikimi i taksës 100% në tregti</b> .....	10
4.1 Importi nga Serbia .....	11
4.2 Importi nga Bosnje e Hercegovina (BiH) .....	15
4.3 Eksporti.....	19
<b>5. Ndikimi në prodhim vendor</b> .....	20
<b>6. Efektet e akcizës në çmimet e konsumit të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike</b> .	23
<b>7. Përfundimi</b> .....	25

## Përmbledhje ekzekutive

Që nga viti 2008, kur Kosova ka shpallur pavarësinë, Kosova dhe Serbia vazhdojnë të kenë tensione tregtare dhe politike. Nga viti 2011, Serbia i ka lejuar importet nga Kosova, mirëpo vazhdimisht ka paraqitur barriera tregtare për eksportet e Kosovës. Për këtë arsye dhe për shkak të cënimit të sigurisë kombëtare, nga nëntori 2018, Qeveria e Kosovës ka vendosur masë mbrojtëse tarifore, fillimisht prej 10% pastaj 100% ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina (BiH). Vendosja e tarifave është në kundërshtim me Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), por, për shkak të kërcënimit me luftë nga ana e Serbisë ndaj Kosovës, marrëveshja e CEFTA-s e lejon aplikimin e masave mbrojtëse përfshirë këtu edhe aplikimin e detyrimeve doganore.

Brenda pesë muajve pas vendosjes së taksës 100%, importet nga Serbia shënuan një rënie prej 88% (160 milionë euro), kurse importet nga BiH u zvogëluan për 83% (24 milionë euro). Gjatë periudhës nëntor 2018 - mars 2019, importi në Kosovë ka vazhduar të rritet krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përfituesit më të mëdhenj gjatë kësaj periudhe ishin shtetet si Sllovenia, Izraeli dhe Turqia të cilat patën ngritje të madhe të eksportit në Kosovë.

Përkundër rënies së importit nga Serbia dhe BiH, deficitit tregtar i Kosovës është rritur. Megjithatë biznese të caktuara vendore kanë mundur të përfitojnë nga masa mbrojtëse, të dhënat tregojnë se rritja e industrisë përpunuese, qoftë në vëllim të punës apo gjenerim të vendeve të reja të punës, nuk është përshpejtuar gjatë periudhës nga kur masa mbrojtëse është në fuqi. Të gjitha këto lënë për të kuptuar se prodhuesit vendor nuk kanë arritur t'i shfrytëzojnë mundësitë e taksës siç është menduar. Në anën tjetër, çmimet e ushqimeve në Kosovë kanë qenë rreth 5.3% më të larta në periudhën sa ka qenë taksa në fuqi (nëntor-mars 2019) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në mungesë të produkteve zëvendësuese për disa prodhime kosovare, prodhuesit vendorë i kanë rritur çmimet me hyrjen në fuqi të taksës prej 100%. Arsye tjera që kanë mundur të ndikojnë në rritjen e çmimeve është rritja e kostos për lëndën e parë dhe rritja e kostos së produkteve të importuara.

Ekzistojnë dyshime se produktet të cilat nuk kanë marka siç janë drithërat, janë duke u regjistruar dhe importuar përmes vendeve të tjera të rajonit si Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Veprimet e tilla dëmtojnë konsumatorët vendorë për arsye se produkti i njëjtë vazhdon të importohet por me kosto më të lartë për shkak të shpenzimeve të transportit.

Duke marrë parasysh barrierat e shumta tregtare të Serbisë ndaj Kosovës, dëmi që iu është shkaktuar bizneseve kosovare mund të jetë më i madh se përfitimi nga largimi i tarifave me marrëveshjen e CEFTAs. Meqenëse zotimi për zbatimin e CEFTA-s është futur edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) të nënshkruar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mundësi për Kosovën është që ta rinegociojë marrëveshjen e CEFTA-s së bashku me vendet tjera anëtare.

## 1. Hyrje

Më 6 nëntor 2018, Qeveria e Kosovës mori vendim që të vendoset një masë mbrojtëse prej 10% ndaj produkteve të importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina (BiH).<sup>1</sup> Nga kjo tarifë u përjashtuan prodhimet e brendeve (markave) ndërkombëtare të cilat prodhohen në këto shtete. Ky vendim dukej i pamenduar mirë sepse përderisa nga tarifa u liruan disa produkte të markave ndërkombëtare, produkte të të njëjtave marka nuk u liruan nga kjo tarifë.<sup>2</sup> Pesëmbëdhjetë ditë më vonë, qeveria ashpërsoi masën e vendosur duke e rritur atë në 100%. Përveç kësaj, qeveria obligoi Doganën e Kosovës që të ndalojë hyrjen e produkteve me mbishkrime të cilat nuk përkojnë me përshkrimin zyrtar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>3</sup> Ky vendim ishte marrë vetëm një ditë pas dështimit të anëtarësimit të Kosovës në Interpol, i cili dështim sipas Qeverisë së Kosovës erdhi si pasojë e fushatës së Serbisë.<sup>4</sup> Arsyetimi i këtij vendimi ishte shkelja e vazhdueshme e Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina në raport me Kosovën mirëpo edhe për arsye se "Serbia është duke e cënuar edhe sigurinë kombëtare".<sup>5</sup> Një muaj më pas, më datë 28 dhjetor, Qeveria e Kosovës vendosi që taksën prej 100% ta aplikojë edhe në brendet ndërkombëtare me origjinë nga Serbia dhe BiH.<sup>6</sup>

Sipas Doganës së Kosovës, në mesatare, vlera vjetore e importit të rregullt nga Serbia është 400 milionë euro dhe rreth 80 milionë euro nga BiH. Deri në vitin 2017, Serbia ishte vendi i parë me pjesëmarrjen më të lartë në import. Në disa kategori ushqimore, Kosova importon deri në 95% të mallit nga Serbia.<sup>7</sup> Marrë parasysh përqindjen e lartë të varshmërisë së Kosovës në import të produkteve me origjinë nga Serbia, vendosja e tarifës prej 100%, paraqet një ndikim të madh në çmimet e konsumit vendor dhe prodhimin e brendshëm. Megjithatë vendimi pritej të ketë ndikim të madh ekonomik, Qeveria e Kosovës nuk ka prezantuar ndonjë hulumtim paraprak për efektet e kësaj tarife. Duke parë rëndësinë ekonomike dhe sociale të një vendimi të tillë, Instituti GAP ka analizuar ndikimet afatshkurta ekonomike të tarifës. Specifikisht, kjo analizë vlerëson efektet e tarifës në prodhim të brendshëm, çmimet e konsumit dhe tregti.

---

<sup>1</sup>Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Vendimi 74. Burimi: <https://bit.ly/2FJHLMH>

<sup>2</sup> Në këtë analizë termet tarifë, taksë, ose masë mbrojtëse kanë kuptimin e njëjtë dhe i referohen taksës 100%.

<sup>3</sup> Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Vendimi 76. Burimi: <https://bit.ly/2FJHLMH>

<sup>4</sup> Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Deklaratë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Burimi: <http://bit.ly/30bRy5c>

<sup>5</sup> Zyra e Kryeministrit të Kosovës, "Kryeministri Haradinaj: Masa prej 100 për qind ndaj Serbisë, shkak i bllokimit të vendit për t'i gëzuar të drejtat e CEFTA-s", Burimi: <http://bit.ly/2H3SAr0>

<sup>6</sup> Zyra e Kryeministrit të Kosovës, Vendimi 06/82, 28 dhjetor 2018, Burimi:

<sup>7</sup> Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Analiza e Importit, Eksportit dhe Prodhimtarisë së Drithërave në Kosovë. Faqe 6. Burimi: <https://bit.ly/2DKYtc3>

Për vlerësimin e ndikimit në tregti të jashtme janë përdorur të dhënat e Doganës së Kosovës të impotit dhe eksportit të rregullt. Për këtë qëllim janë përdorur dy periudha krahasuese: para dhe pas taksës 100%. Periudha para taksës përfshin muajt nëntor 2017-mars 2018, kurse pas taksës nëntor 2018 - mars 2019. Të dhënat lidhur me çmimet e konsumit në ushqim janë të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Për të matur distancën në mes të indeksit botëror të çmimeve të ushqimit dhe indeksit të çmimeve të ushqimit në Kosovë, është përdorur indeksi i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) "IMF Primary Commodity Prices Index". Indeksi është konvertuar nga çmimet në dollar në euro me vlerën mesatare të shkëmbimeve valutore të publikuara nga FMN. Të dhënat lidhur me deklarin e qarkullimit dhe punësimit nga industria përpunuese janë marrë nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

## **2. Rregullimi i tregtisë mes Kosovës dhe Serbisë 1999-2018**

Që nga viti 1999, rregullimi ligjor i bashkëpunimit tregtar në mes të Kosovës dhe Serbisë ka ndryshuar disa herë. Rregullimi ligjor në mes të këtyre dy vendeve mund të ndahet në tri periudha:

- 1999-2008. Duke qenë se Kosova deri në vitin 1999 ishte pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), tregtia në mes të Kosovës dhe Serbisë është konsideruar tregti e brendshme. Me largimin e administratës së RFJ-së nga Kosova, ka përfunduar edhe administrimi i doganës së Kosovës sipas atij regjimi tregtar. Megjithatë administrata serbe ishte larguar nga Kosova duke filluar nga qershori i vitit 1999, UNMIK-u nuk kishte vendosur kontrollat kufitare doganore deri më 3 shtator 1999. Në vitin e parë të themelimit, pikat kufitare doganore ishin vendosur vetëm në pikat kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë, ndërsa për shkak të frikës së thyerjes së Rezolutës 1244, taksat në import nuk ishin mbledhur në pikat kufitare me Serbi dhe Mal të Zi. Taksat në import ishin 10%, me disa përjashtime për produkte medicinale dhe agrokulturore.<sup>8</sup> Tatimi për produktet nga Mali i Zi dhe Serbia ka filluar të mbledhet për herë të parë në vitin 2001, me aprovimin e Rregullores së UNMIK-ut për tatimin mbi vlerën e shtuar në maj të atij viti.<sup>9</sup> Mirëpo, taksat në import ishin mbledhur

---

<sup>8</sup> Banka Botërore, "Kosovo: The economic and social reforms for peace and reconciliation", Maj 2001, Burimi: <http://bit.ly/2NHGF1ë>

<sup>9</sup> International Alert, "Regulation of trade across conflicted areas", Prill 2015, Burimi: <http://bit.ly/2ApE83y>

vetëm për vendet jashtë RFJ-së megjithëse Kosova dhe RFJ nuk kishin një marrëveshje për tregti të lirë.<sup>10</sup>

Në vitin 2001, edhe Serbia për herë të parë filloi të aplikojë një taksë prej 5% në produktet e eksportit në Kosovë. Kjo taksë ishte vendosur si pasojë e dallimeve në mes të shkallës së TVSH-së dhe taksës në shitje (*sales tax*) në Kosovë dhe Serbi dhe ishte anuluar në vitin 2005 me ndërrimin e ligjeve. Në anën tjetër, eksportet nga Kosova në Serbi paguanin taksën e plotë në shitje prej 20%. Ndërsa, duke marrë parasysh se produktet e prodhuara në Kosovë për shtetin serb konsideroheshin produkte vendore, nuk ishte aplikuar taksë doganore, por vetëm akcizë.<sup>11</sup>

- 2008-2011. Në korrik të vitit 2007, Kosova së bashku me pesë vende tjera të Ballkanit Perëndimor bëhet anëtare e marrëveshjes për tregti të lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Ratifikimi i kësaj marrëveshje ishte nënshkruar nga UNMIK-u dhe gjithashtu UNMIK-u do ta përfaqësonte Kosovën në CEFTA. Përmes CEFTA-s u krijua një zonë e lirë tregtare përmes së cilës ndër të tjera u shfuqizuan të gjitha taksat doganore në import dhe eksport të produkteve.<sup>12</sup> Përfaqësimi i Kosovës nga UNMIK-u, ishte konsideruar i pranueshëm për Serbinë duke qenë se respektonte rezolutën 1244 dhe për këtë arsye tregtia me Serbi kishte vazhduar në mënyrë normale deri në shpalljen e pavarësisë nga Kosova. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në dhjetor 2008, Kosova filloi t'i ndërrojë vulat doganore nga simbolet e UNMIK –ut me ato të Republikës së Kosovës.<sup>13</sup> Për këtë arsye, Serbia dhe BiH i vunë bllokadë eksporteve të Kosovës deri në shtator të vitit 2011 apo më shumë së dy vite e gjysmë. Ndaj këtij vendimi të Serbisë dhe BiH, Kosova vendosi masa reciprociteti më 20 korrik 2011, apo dy vite e gjysmë pas bllokadës së eksporteve kosovare.<sup>14</sup>
- 2011-2018. Në mars të vitit 2011, fillon dialogu teknik Kosovë-Serbi, përmes së cilit ndër të tjera do të diskutohej edhe rregullimi i lëvizjes së mallrave.<sup>15</sup> Përmes këtij dialogu, me datë 2 shkurt 2011, Serbia njohu vulat doganore të Kosovës me emrin “Dogana e Kosovës”. Njohja e vulave nga ana e Serbisë, gjithashtu e kishte zgjidhur

---

<sup>10</sup> Banka Botërore, “Kosovo, FR Yugoslavia Medium – Term Public Expenditure”, Burimi: <http://bit.ly/2Ttamëa>

<sup>11</sup> Predrag Bjelic, “Trade Betëeen Kosovo and Serbia”, Prill 2015, Burimi: <http://bit.ly/2ApË83y>

<sup>12</sup> CEFTA, Annex 1 to the agreement on amendment of and accession to the Central European Free Trade Agreement, Neni 1 dhe 8, Burimi: <http://bit.ly/2C4lIV>

<sup>13</sup> Instituti GAP, “Kosova në CEFTA: Të jesh apo të mos jesh?”, Mars 2011, Burimi: <http://bit.ly/2EIXbyP>

<sup>14</sup> International Alert, “Regulation of trade across conflicted areas”, Prill 2015, Burimi: <http://bit.ly/2ApË83y>

<sup>15</sup> Zyra e Kryeministrit, “Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri : Në raundin e parë të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë nuk është arritur ndonjë marrëveshje, porse ka përparime në temat e diskutuara”, Burimi: <http://bit.ly/2PduSfy>



problemin e bllokadës tregtare në mes Kosovës dhe Serbisë e cila bllokadë ishte larguar me 15 shtator të atij viti.<sup>16</sup>

- Nëntor 2018. Qeveria e Kosovës vendos tarifen 10% ndaj produkteve me origjinë nga Serbia. Dy javë më pas kjo tarifë rritet në 100% dhe vazhdon të mbetet në fuqi deri në shkrimin e këtij raporti.

### **3. A është taksë në kundërshtim me marrëveshjen e CEFTA-s?**

CEFTA është nënshkruar në vitin 1992, ndërsa ka filluar së zbatuari në vitin 1994. Fillimisht, shtetet anëtare të kësaj marrëveshje ishin Polonia, Hungaria, Republika Çeke dhe Sllovakia. Qëllimi i marrëveshjes është mobilizimi i përpjekjeve të përbashkëta për anëtarësim në BE përmes tregtisë së lirë ndërmjet vendeve.<sup>17</sup> Pas anëtarësimit në BE, disa nga vendet anëtare të CEFTA-s e kanë braktisur këtë marrëveshje, ndërsa aktualisht anëtare janë: Kosova, Serbia, Mali i Zi, Bosnje e Hercegovina, Moldavia dhe Shqipëria. Përveç obligimit të palëve për shfuqizimin e tarifave doganore, kjo marrëveshje ka edhe këto objektiva:

- Eliminimi i barrierave dhe lehtësimi i lëvizjes së lirë të mallrave në tranzit;
- Ofrimi i kushteve për konkurrencë të barabartë në produkte që e ndikojnë tregtinë;
- Ndihmë vendeve anëtarë në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian;
- Përmirësimi i kushteve për promovimin e investimeve, përfshirë investimet e huaja direkte<sup>18</sup>

Zotimi për zbatimin e kësaj marrëveshjeje nga ana e Kosovës është përfshirë edhe në Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim, të nënshkruar me BE-në.<sup>19</sup>

Palët nënshkruese të marrëveshjes duhet t'i marrin të gjitha masat për përmbushjen e obligimeve dhe qëllimeve të marrëveshjes. Gjithashtu, palët duhet të provojnë t'i zgjidhin mosmarrëveshjet përmes bashkëpunimit apo përmes Komitetit të Përbashkët. Ky komitet i përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare e mbikëqyr dhe administron zbatimin e

---

<sup>16</sup> European Union, "Press statement EU facilitated dialogue: Agreement on Customs Stamps and Cadastre", Burimi: <http://bit.ly/2lrRZ5K>, 2 shtator 2011

<sup>17</sup> CEFTA, "History of CEFTA", Burimi: <http://bit.ly/2vc8dHs>

<sup>18</sup> CEFTA, Annex 1 to the agreement on amendment of and accession to the Central European Free Trade Agreement, Neni 1 dhe 8, Burimi: <http://bit.ly/2C4lLIV>

<sup>19</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/I -069 për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizimit asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në një të anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër



marrëveshjes. Komiteti merr vendime lidhur me rastet e rregulluara në marrëveshje, ndërsa në çështjet tjera jep rekomandime.<sup>20</sup> Në rast se palët nuk mund t'i zgjidhin brenda 90 ditësh kontestet përmes këtij komiteti, atëherë mund t'i drejtohen arbitrazhit.<sup>21</sup>

Mirëpo, ka disa situata në të cilat obligimet nga marrëveshja e CEFTA-s mund të shmangen nga shtetet anëtare. Sipas nenit 18, pika 2C e kësaj marrëveshje "asgjë në këtë marrëveshje nuk e ndalon një palë të marrë masa, të cilat i konsideron të nevojshme për mbrojtjen e interesit kombëtar ose për zbatimin e politikave vendore ose detyrimet ndërkombëtare të marra në kohë të luftës ose tensione tjera ndërkombëtare që përbëjnë kërcënim për luftë". Duke marrë parasysh se Kryeministria e Serbisë kishte kërcënuar Kosovën me luftë më rastin e themelimit të ushtrisë së Kosovës, atëherë në bazë të këtij neni, Kosovës i arsyetohet shmangia e obligimeve nga marrëveshja e CEFTA-s, përfshirë këtu edhe aplikimin e detyrimeve doganore për produktet nga Serbia.<sup>22</sup>

Serbia e ka shkelur Marrëveshjen e CEFTA-s në raport me Kosovën edhe përmes barrierave jo-tarifore. Neni 13 i marrëveshjes parasheh largimin e barrierave tregtare në mes të vendeve anëtare. Sipas një raporti të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, pengesat më të shpeshta apo gjysma e barrierave tregtare të raportuara nga bizneset në Kosovë janë në lidhje me eksportimin e produkteve në Serbi (figura 1). Sipas këtij raporti, bizneset kosovare kanë probleme me procedurat doganore, barrierat teknike tregtare me çertifikata dhe burokraci. Gjithashtu, është raportuar se prodhuesit vendorë dëmtohen nga produktet agrikulurore dhe industriale të cilat importohen nga Serbia përmes politikave 'dumping' të çmimeve<sup>23</sup>. Kjo e fundit gjithashtu është në kundërshtim me qëllimet e CEFTA-s.<sup>24</sup>

---

<sup>20</sup> CEFTA, Neni 40,

<sup>21</sup> Ibid, Neni 43


<sup>22</sup> Deutch Welle, "Kosova don një ushtri të vetën, Serbia kërcënon", qasur me 7 maj 2019, Burimi:

<http://bit.ly/2H7EGWd>

<sup>23</sup> Politikat dumping i referohen rastit kur një shtet eksporton një produkt me çmim më të ulët në tregun e huaj importues (p.sh. në Kosovë) sesa çmimi në tregun e brendshëm të eksportuesit (p.sh. në Serbi)

<sup>24</sup> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, "Barrierat Tregtare, Lehtësimi i tregtisë si mjet për eliminimin e tyre", Prill 2018, Burimi: <http://bit.ly/2VdJmS>

**FIGURA 1. BARRIERAT TREGTARE SIPAS VENDIT**



*Burimi: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë*

Studime të ndryshme tregojnë se në prezencë të marrëveshjeve tregtare, shtetet përdorin masa jo-tarifore për t'i mbrojtur produktet vendore të cilat konkurrojnë me ato të importuara.<sup>25</sup> Studimet empirike tregojnë se këto masa kanë ndikim negativ në shkëmbimet tregtare veçanërisht në eksportet e shteteve në zhvillim.<sup>26</sup> Kjo për arsye se rrisin koston e prodhimit dhe kjo e bën pengesë për eksport veçanërisht për firmat e vogla. Kështu, masat jo-tarifore në kategorinë e sanitarisë dhe fitosanitarisë ulin mundësinë që një firmë të eksportojë me 4%, ndërsa për 8% zvogëlohet numri i firmave eksportuese. Gjithashtu, barrierat rrisin për 2% mundësinë që një firmë ta braktisë një treg eksportues. Në anën tjetër për firmat që vazhdojnë të eksportojnë, çmimi i produkteve të tyre rritet nga 6-9%, ndërsa shitjet mund të iu ulen deri në 43%.<sup>27</sup> Të gjitha këto gjetje sugjerojnë, se duke marrë parasysh barrierat e shumta tregtare të Serbisë ndaj Kosovës, dëmi që iu është shkaktuar bizneseve kosovare mund të jetë më i madh se përfitimi nga largimi i tarifave me marrëveshjen e CEFTAs.

#### **4. Ndikimi i taksës 100% në tregti**

Çdo vit, Kosova importon mallra me vlerë prej 400 milionë euro nga Serbia dhe rreth 80 milionë euro nga Bosnje e Hercegovina. Së bashku, këto dy shtete përbëjnë rreth 17% të

<sup>25</sup> Claustre Bajona dhe Josh Ederington, "Domestic Policies, Hidden Protection and the GATT/ËTO", 2009

<sup>26</sup> Disdier et al. (2008), "The impact of regulations on agricultural trade: evidence from the SPS and TBT agreements", Amer. J. Agr. Econ. 90(2)

<sup>27</sup> Fontagne et al., "Product Standards and Margins of Trade: Firm Level Evidence", Journal of International Economics

importit të përgjithshëm të Kosovës. Pas vendosjes së taksës 100% ndaj produkteve me origjinë serbe dhe boshnjake, importi nga këto vende pësoi një rënie drastike prej rreth 90%. Mirëpo përkundër kësaj, të dhënat e fundit të Doganës së Kosovës tregojnë se deficitit tregtar është rritur për 5.4%. Gjatë periudhës nëntor 2018, kur është vendosur taksa, e deri në mars 2019 janë importuar nga të gjitha vendet gjithsej 77 milionë euro (6.4%) më shumë krahasuar me muajt e njëjtë të vitit paraprak.

#### 4.1 Importi nga Serbia

Kosova ka qarkullim tregtar me Serbinë më shumë se me çdo vend tjetër si në import ashtu edhe në eksport. Deri në vitin 2017, produktet me origjinë nga Serbia kishin pjesëmarrjen më të lartë në importin e përgjithshëm të Kosovës. Për vite me radhë, prodhimi vendor nuk ka arritur t'i plotësojë nevojat e konsumit të brendshëm. Si rezultat, Kosova vazhdon të ketë varësi të lartë në importin e disa produkteve ushqimore. Tabela 1 paraqet kategorinë e produkteve ku Kosova ka varësi më të theksuar ndaj mallrave serbe.

**TABELA 1. VARËSIA E KOSOVËS NË IMPORTIN E PRODUKTEVE SERBE SIPAS PËRQINDJËS NË VITIN 2017**

Tariku (Kapitulli)	Përshkrimi	Importi total i Kosovës	Importi nga Serbia	Pjesëmarrja e Serbisë në importin total
Nr. 10	Drithërat	€31,697,476	€26,280,498	83%
Nr. 23	Mbetjet dhe kthimet nga industritë ushqimore, ushqim për kafshët	€18,735,977	€11,644,703	62%
Nr. 22	Pijet, alkoolet dhe uthullat	€75,150,175	€41,016,016	55%
Nr. 15	Vajra dhe dhjamra prej kafshëve apo bimore	€27,903,307	€14,495,162	52%
Nr. 17	Ëmbëlsirat dhe sheqernat	€35,316,122	€20,910,653	59%
Nr. 01	Kafshë të gjalla	€10,873,269	€ 7,535,299	69%
Nr. 74	Bakri dhe artikuj prej bakri	€8,551,992	€ 4,762,112	56%
Nr. 32	Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike	€34,130,744	€10,135,005	30%
Nr. 48	Letra dhe kartoni	€40,894,464	€13,299,232	33%
Nr. 11	Produktet e industrisë bluajtëse; malt; niseshtet	€10,821,558	€6,353,649	59%
Nr. 34	Sapuni, agjentet organike	€34,889,832	€7,780,886	22%
Nr. 31	Plehëruesit	€15,953,774	€1,741,110	11%


*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*

Një ndër produktet më esenciale ku Kosova importon nga Serbia në sasi të lartë janë drithërat. Në vitin 2017, Kosova importoi gjithsej drithëra me vlerë prej 31.6 milionë euro, ku 83% e saj erdhi nga Serbia (Aneksi 1). Një varësi e theksuar ekziston edhe në kategori të

tjera ushqimore si: llojet e ndryshme të mishit, mbetjet ushqimore të përdorura si ushqim për kafshë, pijet alkoolike dhe joalkoolike, vajrat e ndryshme si dhe produktet ushqimore të ëmbla.

Pas vendosjes së taksës, brenda pesë muajve, importet nga Serbia shënuan një rënie prej 88% apo rreth 160 milionë euro më pak krahasuar me muajt e njëjtë të vitit paraprak. Figura 2 paraqet trendin e rënies së importit në muajt.

**FIGURA 2 VLERA TOTALE E MALLRAVE TË IMPORTUARA NGA SERBIA PËR MUAJT PARA DHE PAS TAKSËS**



*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*

Pas vendosjes së taksës në nëntor 2018, vërehet një rënie e theksuar e importit nga Serbia e cila është përcjellur edhe në muajt në vijim. Në muajin e parë pas hyrjes në fuqi të tarifës prej 10%, rënia e importit ishte më e lehtë. Për shkak të rritjes së tarifës në 100%, ndikimi në import vërehet më qartë në dhjetor 2019 ku importi nga Serbia ka rënë për afër 90% (41 milionë euro) krahasuar me dhjetorin e vitit 2018.

Të dhënat e Doganës tregojnë se pas vendosjes së taksës, importi i produkteve ku Serbia kishte pjesëmarrje të lartë, në masë të madhe është zëvendësuar me vendet e tjera. Në Tabelën 2 mund të shohim se pas taksës, importi i drithërave ka mbetur relativisht i njëjtë. Rënia e importit nga Serbia për 87% është zëvendësuar me vendet e rajonit. Përfituesit më të mëdhenj në këtë kategori kanë qenë Bullgaria dhe Kroacia ku importi nga këto vende është rritur për më shumë se 2,000%. Ekzistojnë dyshime se produktet të cilat nuk kanë marka siç janë drithërat, janë duke u regjistruar dhe importuar përmes vendeve të tjera të

rajonit si Bullgaria, Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria<sup>28</sup>. Veprimet e tilla dëmtojnë konsumatorët vendorë për arsye se produkti i njëjtë vazhdon të importohet por me kosto më të lartë për shkak të shpenzimeve të transportit.

---

<sup>28</sup> Ministri i Tregtisë, Turizmit dhe Telekomunikimit në Qeverinë e Serbisë, Rasim Lajiq. Burimi: <https://bit.ly/2J0E9Yd>

**TABELA 2. IMPORTI I PRODUKTEVE ME VARËSI TË LARTË NGA SERBIA PARA DHE PAS TAKSËS DHE ZËVENDËSIMI I ORIGINËS SË IMPORTIT.**

Tariku	Përshkrimi	Para taksës (Nëntor 2017- Mars 2018)	Pas taksës (Nëntor 2018-Mars 2019)	Ndryshimi	Zëvendësimi i origjinës pas taksës 100%
Nr. 10	Drithërat	€14,358,962	€14,123,620	-1.6%	Serbia - 87% Bullgaria +24933%, Kroacia +2078%
Nr. 23	Mbetjet nga industritë ushqimore, ushqim për kafshët	€7,910,667	€6,229,507	-21.3%	Serbia - 88% Maqed.V. +468%, Bullgaria +308%
Nr. 22	Pijet, alkoolet dhe uthullat	€25,291,480	€25,675,950	1.5%	Serbia - 50% Maqed.V. +282%, Shqipëria + 34%
Nr. 15	Vajra dhe dhjamra prej kafshëve apo bimore	€12,568,222	€10,578,943	-15.8%	Serbia -90% Kroacia +522%, Maqed.V. +398%
Nr. 17	Ëmbëlsirat dhe sheqernat	€11,514,877	€10,714,179	-7.0%	Serbia -91% Franca +4256%, Polonia +765%
Nr. 01	Kafshë të gjalla	€5,029,070	€8,697,122	72.9%	Serbia -97% Rumania +16030%, Republika.Ç +974%
Nr. 74	Bakri dhe artikuj prej bakri	€3,104,677	€3,444,164	10.9%	Serbia -91% Bullgaria +2193%, Turqia 923%
Nr. 32	Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike	€8,859,662	€9,438,312	6.5%	Serbia -87% Turqia +65%, Shqipëria +64%
Nr. 48	Letra dhe kartoni	€15,947,154	€17,161,484	7.6%	Serbia -84% Shqipëria + 221, Maqed.V. 121%
Nr. 11	Produktet e industrisë bluajtëse; niseshtet	€3,221,844	€4,190,976	30.1%	Serbia -89% Maqed.V. +8065%, Shqipëria +289%
Nr. 34	Sapuni, agjentet organike	€13,982,377	€12,437,011	-11.1%	Serbia -92% Italia +48%, Polonia +27%
Nr. 31	Plehëruesit	€7,143,351	€5,989,174	-16.2%	Serbia -94 % Hungaria +438%, Greqia +149%

*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*

Përkundër tarifës së lartë, një numër i vogël i produkteve vazhdon të importohet nga Serbia. Ndër produktet më të importuara pas taksës janë pijet alkoolike dhe joalkoolike, energjia elektrike, gazi dhe vajrat prej naftës, kemikale të ndryshme dhe materiale ndërtimore. Këto produkte duket se kanë qenë më vështirë të zëvendësohen.

Pas vendosjes së tarifës, për disa muaj nuk është vërejtur mungesa e produkteve serbe tek shitësit me pakicë. Kjo për arsye se kompanitë tregtare theksonin se kishin stoqe të mjaftueshme për të furnizuar shitësit me pakicë me produkte serbe për disa muaj, ndërsa në anën tjetër me vendosjen e flamujve<sup>29</sup>, konsumatorët kanë filluar të konsumojnë më pak produkte serbe.<sup>30</sup> Dyshimi nëse produktet ekzistuese tek shitësit janë si rezultat i stoqeve apo kontrabandës do të jetë më i qartë në muajt në vijim kur pritet të harxhohen të gjitha stoqet e pretenduara.

#### 4.2 Importi nga Bosnje e Hercegovina (BiH)

Bosnje e Hercegovina është një tjetër partner i rëndësishëm tregtar i Kosovës. Mirëpo, në krahasim me Serbinë, Kosova është më pak e varur nga importi i BiH. Në vitin 2018, pjesëmarrja e produkteve me origjinë nga BiH ishte rreth 2%. Tabela 3 paraqet kategoritë e produkteve ku Kosova ka varësinë më të theksuar ndaj mallrave të BiH.

**TABELA 3. VARËSIA E KOSOVËS NË IMPORTIN E PRODUKTEVE BIH SIPAS PËRQINDJËS NË VITIN 2017**

Tariku (Kapitulli)	Përshkrimi	Importi total i Kosovës	Importi nga BiH	Pjesëmarrja e Serbisë në importin total
Nr. 72	Hekur dhe çelik	€161,765,124	€32,224,618	20%
Nr. 16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve	€27,338,391	€7,668,988	28%
Nr. 4	Produktet bulmetore, vezët e zogjve, mjaltë nat	€44,978,449	€5,580,550	12%
Nr. 44	Druri dhe artikujt prej druri, qymyri i drurit	€76,614,613	€6,183,841	8%
Nr. 30	Produktet farmaceutike	€66,369,649	€2,935,223	4.4%

<sup>29</sup> Udhëzimi administrativ për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të flamurit mbi origjinën e produktit. Burimi: <https://bit.ly/2ËtUFTQ>

<sup>30</sup> Intervistë me menaxherin e përgjithshëm të njëres nga rrjetet e dyqaneve të shitjes me pakicë



Edhe pse varësia e Kosovës në importet e BiH është relativisht e vogël, produktet të cilat importohen nga ky shtet kanë rëndësi të veçantë për tre sektorë mjaft konkurrues në Kosovë si: sektori i ndërtimtarisë, sektori i bylmetit dhe sektori i përpunimit të drurit<sup>31</sup>. Deri më tani, hekuri dhe çeliku është kategoria e produkteve më e importuar nga BiH. Kjo për arsye se BiH ka përfaqësinë e kompanisë 'ArcelorMittal' e cila është një ndër kompanitë më të mëdha botërore në eksportin e hekurit dhe të çelikut. Prandaj, tarifa në këto produkte mund të rrisë koston në sektorin e ndërtimtarisë në Kosovë posaçërisht kur fillon sezona e ndërtimit. Për shembull, çmimi i llamarinës prej çelikut u importua në muajin janar – mars 2018 për 0.84 euro për peshë neto ndërsa në muajt e njëjtë të vitit 2019 u importua për 1.20 euro (ngritje prej 44%)<sup>32</sup>.

Dy sektorë të tjerë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës janë sektori i produkteve bulmetore dhe përpunimi i drurit. Kosova, vitet e fundit, ka ngritur konkurrueshmërinë rajonale në këto dy sektorë. Andaj mungesa ose ngritja e çmimit të importit të këtyre produkteve si pasojë e tarifës do të mund të ofronte mundësi për prodhuesit vendorë që të zgjerojnë tregun e tyre.


Brenda pesë muajve të parë pas vendosjes së taksës, importet nga BiH u zvogëluan për 83% apo rreth 24 milionë euro më pak. Figura 3 paraqet trendin e rënies krahasuar me muajt e njëjtë të vitit paraprak.

---

<sup>31</sup> Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Tregjet Potenciale për Eksport. Burimi: <https://bit.ly/2IFfëAg>

<sup>32</sup> Krahasim i Institut GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës.

**FIGURA 3 VLERA TOTALE E MALLRAVE TË IMPORTUAR NGA BIH PËR MUAJT PARA DHE PAS TAKSËS**



*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*

Një sasi e vogël e produkteve ushqimore prej mishit dhe produkteve bulmetore vazhdojnë ende të importohen nga BiH edhe pas vendosjes së taksës. Ndërkaq, sasia tjetër e cila nuk importohet më nga BiH, blihet nga vendet e tjera. Orientimi i tregut nga BiH për në vendet e tjera është i paraqitur në tabelën 4. Kategoria më e rëndësishme është ajo e hekurit dhe çelikut, ku BiH humbi 93% të tregut në krahasim me muajt e njëjtë para vendosjes së taksës. Tregu i humbur nga BiH u zëvendësua kryesisht me importin nga Turqia dhe Greqia.

Ndërkaq, tek produktet bulmetore pritej që importi i tyre të jetë shumë më i vogël pas vendosjes së taksës dhe kjo rënie e importit të zëvendësohet me prodhimin vendor. Mirëpo, të dhënat e Doganës tregojnë se edhe pse këto produkte që vinin nga BiH kanë shënuar një rënie prej 80%, vlera e importit të kësaj kategorie është rritur për 7.3% e cila u orientua në vendet si Kroacia dhe Polonia.

**TABELA 4. IMPORTI I PRODUKTEVE ME VARËSI TË LARTË NGA BOSNIA DHE HERCEGOVINA PARA DHE PAS TAKSËS DHE ZËVENDËSIMI I ORIGJINËS SË IMPORTIT**

Tariku	Përshkrimi	Para taksës (Nëntor 2017-Mars 2018)	Pas taksës (Nëntor 2018-Mars 2019)	Ndryshimi	Zëvendësimi i origjinës pas taksës 100%
Nr. 72	Hekuri dhe çeliku	€76,221,273	€75,492,965	-1.0%	BiH -93% Turqia +642%, Greqia +259%
Nr. 16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve	€9,784,421	€9,855,083	0.7%	BiH -37% Gjermania +115%
Nr. 04	Produktet bulmetore	€18,043,063	€19,354,671	7.3%	BiH -80% Kroacia +132%, Polonia 60%
Nr. 44	Druri dhe artikujt prej druri, qymyri i drurit	€24,939,564	€24,537,737	-1.6%	BiH -86% Bullgaria +541%, Rumania +67%
Nr. 30	Produktet farmaceutike	€30,754,108	€29,734,290	-3.3%	BiH -89% Finlanda +117098%, Danimarka +177%

*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*

Të dhënat e tregtisë tregojnë se përkundër rrezikut që i kanosej Kosovës nga varshmëria e lartë në importin e produkteve nga Serbia dhe BiH, kompanitë tregtare arritën që në masë të madhe të zëvendësojnë origjinën e importit brenda një periudhe shumë të shkurtër. Kjo tregon se Kosova ka një fleksibilitet sa i përket sigurimit të mallrave nga vendet e tjera të rajonit megjithëse në të shumtën e rasteve ajo po përcillet me një kosto më të lartë.

Tabela 5 paraqet humbësit dhe përfituesit më të mëdhenj nga hyrja në fuqi e taksës 100%. Në këtë tabelë janë përfshirë të gjithë sektorët e importit. Këto të dhëna tregojnë se brenda pesë muajve të hyrjes në fuqi të taksës, nga Serbia janë importuar rreth 160 milionë euro më pak ndërsa nga BiH afër 24 milionë krahasuar e muajt njëjtë të vitit paraprak. Nga kjo masë kanë përfituar vendet si Sllovenia e cila gjatë kësaj periudhe kishte një ngjitje prej 125% (34.3 milionë euro), Izraeli me 659% (17.4 milionë euro) dhe Turqia me 34% (37.2 milionë euro).

**TABELA 5. IMPORTI I PRODUKTEVE ME VARËSI TË LARTË NGA BOSNJE E HERCEGOVINA PARA DHE PAS TAKSËS DHE ZËVENDESIMI I ORIGJINËS SË IMPORTIT**

Origjina	Para taksës (Nëntor 2017- Mars 2018)	Pas taksës (Nëntor 2018- Mars 2019)	Ndryshimi në %	Diferenca
Serbia	€181,375,871	€22,314,705	-88%	€ - 159,061,165
BiH	€28,448,999	€4,697,547	-83%	€ - 23,751,452
Izraeli	€2,644,890	€20,081,039	659%	€ 17,436,149
Sllovenia	€27,386,150	€61,754,120	125%	€ 34,367,970
Turqia	€108,587,640	€145,814,624	34%	€ 37,226,985
Maqedonia V.	€56,821,247	€80,039,038	41%	€ 23,217,790
Shqipëria	€52,515,508	€79,172,638	51%	€ 26,657,130
Greqia	€47,824,186	€71,642,372	50%	€ 23,818,187
Kina	€113,649,300	€130,827,631	15%	€ 17,178,331
Hungaria	€13,247,468	€20,837,398	57%	€ 7,589,930
Bullgaria	€26,739,799	€36,341,455	36%	€ 9,601,656
Franca	€17,651,002	€25,478,951	44%	€ 7,827,950

*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*


### 4.3 Eksporti

Përkundër barrierave të shumta jotarifore me të cilat Kosova vazhdon të përballet me vite, Serbia dhe BiH vazhdojnë të jenë partnerë të rëndësishëm të Kosovës sa i përket eksporteve. Në vitin 2018 këto dy vende ishin destinacion i mallrave me vlerë afër 40 milionë euro eksporte kosovare. Pra, 10% e eksportit të Kosovës shkon në Serbi ndërsa 2.3% në BiH.

Pas vendosjes së taksës 100%, u mendua se do të fillojë një luftë tregtare e cila do të vështirësojë edhe më shumë ekportin e produkteve kosovare. Mirëpo, të dhënat e Doganës së Kosovës dhe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) tregojnë se një gjë e tillë nuk po ndodh. Përveç barrierave jotarifore që Serbia dhe BiH i kanë vendosur për vite ndaj eksportuesve kosovarë, nuk vërehet një intensifikim i tyre gjatë kohës kur Kosova ka vendosur taksën. Figura 4 paraqet eksportin e mallrave kosovare të destinuar për Serbi

dhe BiH. Nga këto të dhëna nuk vërehet një rënie e eksportit në muajt kur është vendosur taksa. Po ashtu, departamenti i tregtisë në MTI ka konfirmuar se nuk ka pranuar ndonjë ankesë shtesë nga eksportuesit kosovarë për barrierë të shtuara nga Serbia dhe BiH gjatë kohës kur po zbatohet taksa.<sup>33</sup>

**FIGURA 4. TË DHËNAT PËR EKSPORT ME SERBINË DHE BIH PËR VITIN 2017 DHE 2018**



*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*

## 5. Ndikimi në prodhim vendor

Marrë parasysh që Kosova ka një varësi të lartë në një numër të madh të artikujve ushqimorë dhe të lëndës së parë të importuar nga Serbia dhe BiH, vendosja e tarifës paraqiste rrezik për disa kompani që importonin lëndën e parë dhe mundësi për disa që ishin konkurrent me produktet serbe dhe boshnjake.

Të dhënat e Doganës së Kosovës, të paraqitura në tabelën 2 dhe 4 më lartë, tregojnë se pothuajse vlera e njëjtë e produkteve vazhdon të importohet edhe pas taksës duke mos lënë shumë hapësirë për prodhimin vendor. Dallimi kryesor qëndron tek ndryshimi i origjinës së importit dhe në shumë raste i çmimit më të lartë. Importi i kafshëve të gjalla është një shembull ku Kosova kishte varësi të lartë (69%) ndaj Serbisë. Mirëpo, në tabelën 6 shohim se edhe pas vendosjes së taksës, pesha e llojeve të ndryshme të kafshëve të

<sup>33</sup> Takim me Sytrime Dervishollin - MTI, 19 Prill, 2019.

importuara nuk është zvogëluar por në fakt është rritur. Origjina e importit ka kaluar nga Serbia në vendet si Republika Çeke dhe Rumania (tabela 2). Një tjetër produkt konkurrent është materiali ndërtimor. Gjatë muajit janar-mars 2018, janë importuar 83.6 milionë peshë neto hekur dhe çelik ndërsa në muajt e njëjtë të vitit 2019 janë importuar rreth 88 milionë peshë.

**TABELA 6. PESHA E KAFSHËVE TË GJALLA TË IMPORTUARA NË MUAJT PARA (NËNTOR 2017-MARS 2018) DHE PAS (NËNTOR 2018-MARS2019) TAKSËS.**

Importi	Pesha e importuar para taksës	Pesha e importuar pas taksës	Dallimi
Mëshqerra racë për riprodhim	88,220	235,190	167%
Gjedhe për therrje	186,530	296,765	59%
Mëshqerra për therje	67,466	61,697	-9%
Lopë për therje	760,643	805,920	6%
Dema, mezate për therje	1,156,948	1,741,837	51%
Të tjera	14,041	12,309	-12%


*Burimi: Instituti GAP bazuar në të dhënat e Doganës së Kosovës*

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vëllimi i industrisë prodhuese gjatë tre mujorit të fundit 2018 ka rënë për 3.6%, ndërsa numri i të punësuarve për 2.6%.<sup>34</sup> Në mungesë të të dhënave për prodhim industrial për tre mujorin e parë të vitit 2019, kemi analizuar të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës sa i përket deklarimit të qarkullimit dhe numrit të të punësuarve. Pra, duhet pasur parasysh se këto të dhëna nuk e përfshijnë edhe aktivitetin informal të bizneseve.

Sa i përket deklarimit të qarkullimit, shohim se në muajin dhjetor 2018 kur ka qenë në fuqi tarifa për importet nga Serbia dhe BIH prej 100%, industria përpunuese ka deklaruar pothuajse nivel të njëjtë të aktivitetit biznesor krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa në muajin nëntor kur taksa ishte vetëm 10% kjo industri ka deklaruar 23% rritje të qarkullimit krahasuar me dhjetorin e vitit paraprak. Në periudhën janar-shkurt 2018 (periudha pa masën mbrojtëse) bizneset kanë deklaruar rritje në qarkullim prej 18% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa në periudhën janar-shkurt 2019 (periudha me masën mbrojtëse) qarkullimi i deklaruar është rritur për vetëm 2%.

<sup>34</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Statistikat Afatshkurta të Industrisë TM4 2018", Burimi: <http://bit.ly/2PëRFDë>


**FIGURA 5. DEKLARIMI I QARKULLIMIT TË INDUSTRIISË PËRPUNUESE**



*Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës*

Edhe sa i përket numrit të të punësuarve ka vazhduar një trend normal i rritjes dhe nuk duket që taksa ka pasur ndonjë efekt në përshejtimin e gjenerimit të vendeve të reja të punës. Për shembull, në periudhën janar-shkurt 2018 (periudha pa masën mbrojtëse) bizneset kanë deklaruar rritje prej 13% në numrin e të punësuarve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa në periudhën janar-shkurt 2019 (periudha me masën mbrojtëse) numri i të punësuarvë të deklaruar është rritur vetëm për 6%.

**FIGURA 6. NUMRI I PUNËTORËVE TË DEKLARUAR NË ATK**





## 6. Efektet e akcizës në çmimet e konsumit të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike

Në vitin 2018, Kosova kishte rritjen më të lartë të çmimeve krahasuar me vendet në rajon.<sup>35</sup> Duke marrë parasysh se shumica e importeve nga Serbia janë produkte ushqimore, më poshtë kemi analizuar nëse taksa ka ndikuar në rritjen e çmimeve të ushqimit në Kosovë. Gjithashtu, ushqimi dhe pijet përbëjnë koston kryesore apo 40% të shpenzimeve të një familje kosovare.<sup>36</sup> Rritja e çmimit në këtë kategori të konsumit është veçanërisht problematike për familjet në asistencë sociale të cilat pothuajse tërë buxhetin familjar e shpenzojnë në ushqim prandaj dhe mund ta thellojë varfërinë.

Duke analizuar çmimet gjatë periudhës janar 2017 – mars 2019, në bazë të figurës nr.7 shohim se që nga nëntori kur është vendosur masa e parë mbrojtëse tarifore prej 10% për produktet nga Serbia, indeksi i ushqimit ka arritur vlerën më të lartë në dy vitet e fundit. Në mesatare, çmimet e ushqimeve kanë qenë rreth 5.3% më të larta në periudhën sa ka qenë taksa në fuqi (nëntor-mars 2019) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në mungesë të produkteve zëvendësuese për disa prodhime kosovare, prodhuesit vendor i kanë rritur çmimet me hyrjen në fuqi të taksës prej 100%.<sup>37</sup> Arsye tjera që kanë mund të ndikojnë në rritjen e çmimeve është rritja e kostos për lëndën e parë dhe rritja e kostos së produkteve të importuara.


---

<sup>35</sup> World Bank, "Western Balkans Regular Economic Report No.15: Reform Momentum Needed", Burimi: <http://bit.ly/2XIRrfj>

<sup>36</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, "Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare 2017": Burimi: <http://bit.ly/2E5qUBF>

<sup>37</sup> Intervistë me menaxherin e përgjithshëm të njëres nga rrjetet e shitjeve me pakicë në Kosovë, Prill 2019


**FIGURA 7. INDEKSI I ÇMIMEVE TË USHQIMIT DHE PIJEVE JOALKOOLIKE NË KOSOVË**



**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rritja e çmimeve mund të ketë ardhur edhe si pasojë e rritjes së çmimeve të ushqimit në tregjet ndërkombëtare apo edhe si pasojë e rritjes së çmimeve të naftës. Për këtë arsye kemi matur distancën në mes indekseve të çmimeve të ushqimit dhe pijeve në botë dhe në Kosovë. Edhe ky indikator që nga dhjetori 2019 ka arritur pikën më të lartë që sugjeron se taksa mund të ketë qenë njëra ndër arsyet për rritjen e përsheptuar të çmimeve të konsumit në Kosovë. Gjithashtu, trendet në çmimet e naftës nuk duket se janë faktori që mund ta shpjegojnë gjithë rritjen e këtij indikatori, duke pasur parasysh se gjatë muajve paraprak (për shembull periudha maj 2018-janar 2019) ka pasur çmime edhe më të larta të naftës ndërsa distanca nuk ka qenë aq e lartë.

**FIGURA 8. DISTANCA NË MES TË CMIMEVE BOTËRORE TË USHQIMIT DHE PIJEVE NË BOTË DHE KOSOVË**



**Burimi:** Kalkulim i Institutit GAP bazuar në të dhënat e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës

## 7. Përfundimi

Që nga viti 2008 kur Kosova ka shpallur pavarësinë, Kosova dhe Serbia kanë pasur marrëdhënie të tensionuar tregtare dhe politike. Me gjithë rregullimin e çështjeve të menaxhimit të kufirit dhe anulimin e tarifave tregtare, tregtia mes Kosovës dhe Serbisë vazhdon të pengohet nga barrierat jo-tarifore dhe tensionet politike. Me nënshkrimin e CEFTAs, Kosova ka hyrë në obligime për anulimin e tarifave tregtare, mirëpo për shkak të kërcënimit me luftë nga ana e Serbisë ndaj Kosovës, marrëveshja nuk e ndalon Kosovën që të marrë çfarëdo masa për mbrojtjen e interesit kombëtar, përfshirë edhe vendosjen e tarifave të reja.

Që nga vendosja e masës mbrojtëse (nëntor 2018 - mars 2019), importet nga Serbia dhe BiH shënuan rënie drastike. Përkundër rënies së importit nga këto dy vende, deficitit tregtar i Kosovës është rritur. Të dhënat e Doganës tregojnë se pothuajse vlera e njëjtë e produkteve të importuara nga Serbia dhe BiH vazhdojnë të importohen nga vende tjera, duke mos lënë shumë hapësirë për zëvendësimin e importit nga prodhuesit vendor. Të dhënat nuk tregojnë për ndonjë rritje të përshpejtuar të industrisë përpunuese në Kosovë, qoftë sa i përket vëllimit të prodhimit apo gjenerimit të vendeve të reja të punës. Të gjitha këto lënë për të kuptuar se prodhuesit vendor nuk kanë arritur t'i shfrytëzojnë mundësitë

e taksës siç është paramenduar. Ndërkaq përfituesit më të mëdhenj tregtar gjatë kësaj periudhe duket të jenë shtetet si Sllovenia, Izraeli dhe Turqia.

Sa i përket ndikimit në çmimet e konsumit, tarifa mund t'i ketë rritur dukshëm çmimet e konsumit në ushqim të cilat përbëjnë shpenzimin kryesor të shportës së konsumatorëve kosovarë. Duke marrë parasysh këtë, mbajtja e kësaj takse për një kohë më të gjatë mund të ketë efekte në rritjen e varfërisë. Ndër arsytet që mund të kenë ndikuar në rritjen e çmimeve të produkteve ushqimore janë: ulja e konkurrencës në produkte të caktuara, rritja e kostos së lëndës së parë për bizneset vendore dhe rritja e kostos së transportit dhe çmimeve të produkteve të importuara.

Në anën tjetër, taksa prej 100% nuk i zgjidh problemet tregtare me barrierat jo-tarifore që hasin bizneset e Kosovës që eksportojnë në Serbi. Studimet empirike tregojnë se këto barrierat mund të jenë pengesë edhe më e madhe se barrierat tarifore të cilat janë anuluar me CEFTA-n. Për këtë arsye duhet të bëhen edhe analiza tjera nëse Kosova është duke përfituar ekonomikisht nga kjo marrëveshje në raport me Serbinë. Meqenëse zotimi për zbatimin e CEFTA-s është futur edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit të nënshkruar në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, mundësi për Kosovën është që ta rinegociojë këtë marrëveshje së bashku me vendet tjera anëtare.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:

